

Mirësitë e Medinës

Abdul-Muhsin el Abad

Mirësia e Medinës, edukata e banimit në të dhe vizitës së saj

Shkroi dijetari dhe muhadithi:

Abdul-Muhsin el Abad

Falënderimet i përkasin vetëm Allahut, Atë e lavdërojmë, ndihmë dhe falje prej Tij kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga të këqijat e vetëve dhe punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu s'ka kush që ta humbë dhe atë që e humb Allahu s'ka kush ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, Një i pashok dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij, i dashur i ngushtë i Tij dhe i zgjedhuri i Tij nga të gjitha krijesat. E dërgoi Allahu para se të ndodhë kijameti përgëzues dhe qortues, thirrës për tek Allahu me lejen e Tij dhe pishtar ndriçues, e udhëzoi umetin e tij për çdo të mirë dhe ia tërhoqi vërejtjen nga çdo e keqe. O Allah, çoji salavatet, përsëndetjet dhe bekimet e Tua mbi të, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi gjithë ata që ecin në rrugën e tij dhe pasojnë udhëzimin e tij deri në ditën e gjykimit. E më pas:

Me të vërtetë qyteti i Profetit të ndershëm salallahu alejhi ue selem është qyteti i mirë (Tajbete et-Tajjibeh), djepi i shpalljes, vendi në të cilin zbriste Xhibrili i sinqertë për tek Profeti fisnik. Është qyteti në të cilin kthehet dhe mblidhet besimi, vendtakimi i muhaxhirëve dhe ensarëve, atdheu i atyre që përgatitën vendin dhe besimin (për pritjen e muhaxhirëve), kryeqyteti i parë i muslimanëve, në të u ngritën flamujt e xhihadi për në rrugë të Allahut, prej saj u nisën ushtritë e së vërtetës për ti nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë, prej saj u shpërnda drita e udhëzimit e cila e ndriçoi rruzullin tokësor, është vendi tek i cili u shpërngul Profeti salallahu alejhi ue selem, në të jetoi gjatë gjithë jetës së tij (pas shpërnguljes), në të vdiq, në të u varros, prej saj do të ringjallet, varri i tij do të jetë i pari që do të hapet për ringjallje dhe nuk dihet për asnjë profet në mënyrë të prerë se ku është varri i tij përveç Profetit salallahu alejhi ue selem.

Këtë qytet të bekuar e ka nderuar dhe e ka veçuar Allahu i Lartësuar duke e bërë vendin më të mirë, pas Mekes.Tregon për veçimin dhe vlerësimin e Mekes ndaj Medines, fjala e Profetit salallahu alejhi ue selem kur e nxorën kafirat nga Meka dhe u drejtua për në Medine si

muhaxhir; tha duke iu drejtuar Mekes: "Pasha Allahun, ti je vendi më i mirë (më i zgjedhur) prej tokës së Allahut, je vendi më i dashur tek Allahu dhe sikur të mos më nxirrnin prej teje nuk do të dilja." (Transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe hadithi është i saktë)

Ndërsa për sa i përket një hadithi që i ngjishet Profetit salallahu alejhi ue selem ku thuhet se ai ka thënë:"O Zot, Ti më nxore nga vendi më i dashur tek unë (Meke) prandaj më bëj të banoj tek vendi më i dashur tek Ti (dmth Medine)," ky është hadith meudu (i shpifur, i kotë) dhe kuptimi i tij nuk është i saktë, sepse kjo thënie tregon sikur gjëja më e dashur tek Profeti salallahu alejhi ue selem është tjetër nga ajo që është më e dashur tek

Allahu dhe anasjelltas (gjë e cila nuk është e vërtetë). Dihet se dashuria e Profetit salallahu alejhi ue selem është pasuese e dashurisë së Allahut dhe nuk mund të jetë gjëja më e dashur tek Allahu diçka ndërsa tek Profeti diçka tjetër.

*E pashë të arsyeshme ta shkruaja këtë broshurë rreth mirësisë së këtij qyteti të bekuar, të sqaroja edukatën (rregullat) e banimit në të dhe të vizitës së tij. Do përmend në këtë broshurë disa nga vlerat dhe mirësitë e Medines,

pastaj rregulla dhe edukata të banimit në të, pastaj disa nga rregullat e vizitës së saj.

- Nga mirësitë e këtij qyteti të bekuar është se Allahu e ka bërë Medinen harem (vend të shenjtë) e të sigurt ashtu siç e ka bërë Meken harem (vend të shenjtë) e të sigurt. Është transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem se ka thënë: "Me të vërtetë Ibrahim i ka bërë Meken vend të shenjtë dhe unë e kam bërë Medinen vend të shenjtë." (Transmeton Muslimi)

Qëllimi këtu me bërjen e Mekes vend të shenjtë nga Ibrahim i ka bërë Medinen nga Profeti, është vetëm shfaqja dhe nxjerrja në dukje e kësaj shenjtërie sepse në të vërtetë është Allahu Ai që e ka bërë të shenjtë këtë dhe atë. I ka veçuar Allahu këto dy vende me këtë cilësi (shenjtërinë) dhe nuk ka argument të saktë që tregon për shenjtërinë e ndonjë vendi tjetër përveç Mekes dhe Medines. Përsa i përket asaj që është përhapur nëpër gjuhët e shumë njerëzve se xhamia Aksa është e treta e Dy Haremeve, kjo është gabim sepse nuk ka harem të tretë, mirëpo shprehja e saktë është të thuhet: E treta e dy xhamive madhështore dhe të nderuara. Është transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem argument që tregon për mirësinë e këtyre

tre xhamive dhe vizitës së tyre me qëllim që të falë namaz në to, ku thotë: "Nuk lejohet të ndërmerret udhëtim përveçse për në tre xhami: Mesxhidul Haram (Qabe), në këtë xhaminë time (Medine) dhe në xhaminë Aksa." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

Qëllimi me fjalën harem në Meke dhe Medine është toka që gjendet brenda kufijve rrethues të çdonjërit prej këtyre dy qyteteve, ky është haremi. Kurse për sa i përket asaj që është përhapur: të quajturit harem vetëm xhaminë e Profetit salallahu alejhi ue selem kjo është gabim sepse nuk është vetëm xhamia e Profetit salallahu alejhi ue selem harem, përkundrazi e gjithë Medineja është harem që nga mali Ir deri tek mali Theur dhe çfarë ka ndërmjet dy anëve të saj. Ka thënë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Unë e kam bërë haram të këputen pemët (bimët) dhe të vritet gjahu ndërmjet dy anëve të saj (Medines)." (Transmeton Muslim)

Siç dihet sot qyteti i Medines është zgjeruar shumë, saqë një pjesë e qytetit ka dalur jashtë haremit, prandaj nuk mund të thuhet se të gjitha ndërtesat që gjenden sot në Medine janë në harem. Ato ndërtesa që gjenden brenda kufijve janë harem, ndërsa ato ndërtesa që kanë dalur

jashtë kufijve të haremit u thuhet se janë pjesë e Medines por jo në harem. Është transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem caktimi i kufijve të haremit duke thënë se: Harem është ajo që gjendet ndërmjet dy anëve të saj, ose: Ajo që është mes dy gurove të zeza (harratejni), ose: Ajo që është mes dy maleve, ose: Ajo që është mes malit Ir dhe malit Theur. Nuk ka asnjë lloj kundërshtimi mes këtyre shprehjeve, sepse pjesa më e vogël është e përfshirë në pjesën e madhe, çfarë ka ndërmjet dy anëve të saj është harem, çfarë ka mes dy gurove të zeza është harem, çfarë ka mes malit Ir dhe Theur është harem. Nëqoftëse për një pjesë jemi në dyshim a është apo jo pjesë e haremit, atëherë gjëja më e mirë është ta konsiderojmë prej çështjeve të cilat nuk janë të qarta (el mushtebihat) dhe na ka mësuar Profeti salallahu alejhi ue selem se rruga më e mirë në këto lloj çështjesh të paqarta është të zgjedhësh më të sigurtën, siç thotë në hadithin e transmetuar nga Numan bin Beshir, hadith për të cilin kanë rënë dakord që është i saktë: "Kush iu largohet gjërave të paqarta ka shpëtuar fenë dhe nderin e tij, ndërsa kush bie në të paqartat ka rënë në të ndaluarën."

- Nga mirësitë e tjera të këtij qyteti të bekuar është se Profeti salallahu alejhi ue selem e ka quajtur "Tajbeh" dhe "Tabeh" (i mirë), biles është transmetuar në Sahih Muslim se Allahu i Lartësuar e ka quajtur "Tabeh" (i mirë). Thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Me të vërtetë Allahu e ka quajtur Medinen "Tabeh." Të dy këto emra janë të nxjerrur nga fjala mirësi, i mirë; janë dy emra të mirë me të cilët është quajtur kjo tokë e mirë.

- Nga mirësitë e saj është se besimi (imani) kthehet dhe mblidhet në të, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Me të vërtetë imani kthehet dhe mblidhet në Medine ashtu siç kthehet gjarpëri në folenë e tij." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

Kuptimi i këtij hadithi është se imani përqendrohet në të. Muslimanët e mësyjnë dhe e vizitojnë atë duke u shtyrë nga besimi dhe dashuria që kanë për këtë tokë të bekuar, të cilën e ka bërë të shenjtë Allahu i Lartësuar.

- Nga mirësitë e saj: E ka cilësuar Profeti salallahu alejhi ue selem Medinen si vendbanim që i ha vendbanimet e tjera. Thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Jam urdhëruar (të emigroj dhe banoj) në një vendbanim që i ha vendbanimet e tjera; i thonë asaj Jethrib kurse në të

vërtetë ajo është el Medine." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

Fjala e Profetit salallahu alejhi ue selem:"i ha vendbanimet e tjera," është komentuar:1) Fiton, triumfon mbi vendbanimet e tjera duke mbizotëruar ndaj tyre, 2) Sillen në të të gjitha plaçkat e luftës që fitohen nga xhihadi në rrugë të Allahut dhe transportohen për në Medine.

Të dyja këto gjëra që u përmendën në shpjegimin e kësaj fjale kanë ndodhur dhe janë bërë realitet. Është realizuar mbizotërimi dhe triumfi i këtij qyteti ndaj qyteteve të tjera duke u nisur prej saj udhëzuesit përmirësues si dhe luftëtarët çlirimtarë, të cilët i nxorën njerëzit nga errësirat në dritë me lejen e Zotit të tyre duke u bërë shkak që të hyjnë në fenë e Allahut dhe çdo e mirë që e gëzojnë njerëzit ka dalur nga ky qytet i bekuar, qyteti i Profetit salallahu alejhi ue selem. Pra fakti që Medineja i ha qytetet do të thotë triumfi dhe mbizotërimi i saj ndaj qyteteve të tjera, siç ndodhi në kohën e parë me elitën e shokëve të Profetit salallahu alejhi ue selem dhe me katër halifet e drejtë (Allahu qoftë i kënaqur ndaj tyre), gjithashtu është realizuar arritja e plaçkave të luftës dhe sjellja e tyre në Medine. Profeti salallahu alejhi ue selem

ka lajmëruar se do shpenzohen thesaret e Kirasë dhe Kajsarit për në rrugë të Allahut, gjë e cila ka ndodhur; janë sjellë në Medine këto thesare dhe i ka shpërndarë Umeri radijallahu teala anhu.

- Nga mirësitë e saj është se Profeti salallahu alejhi ue selem ka nxitur që të bëhet durim ndaj vështirësive të ndryshme të Medines ku thotë: "Medineja është më e mirë për ta, sikur ta dinin." E ka thënë këtë fjalë në lidhje me ata të cilët menduan të zhvendoseshin nga Medineja drejt vendeve me furnizim të bollshëm, me gjendje të mirë jetese dhe pasuri të shumta, prandaj tha Profeti salallahu alejhi ue selem: "Medineja është më e mirë për ta, sikur ta dinin. Nuk largohet prej saj dikush duke e nënvleftësuar atë veçse do ta zëvendësojë Allahu në Medine me dikë që është më i mirë se ai. Kush bën durim (qëndron) ndaj ashpërsisë dhe vështirësive të saj do jem ndërmjetësues dhe dëshmues për të Ditën e Gjykimit." (Transmeton Muslim) Ky hadith pra tregon për vlerën e Medines, për vlerën e sabrit ndaj vështirësive, ashpërsisë dhe jetesës së vështirë në të nëse i ndodh dikujt (sepse nuk është e thënë që të gjithë banorët e saj do i përjetojnë këto gjëra) Pra mos të jetë kjo shkak për t'u zhvendosur prej saj dhe të

kërkojë vende me furnizim të bollshëm, jetesë të mirë e pasuri por të bëjë durim duke shpresuar në shpërblimin dhe mirësinë e madhe të premtuar nga Allahu i Lartësuar.

- Nga mirësitë e saj është se Profeti salallahu alejhi ue selem ka sqaruar pozitën e lartë që gëzon ky qytet dhe rrezikshmërinë e të shpikurit në të (ose të praktikuarit e bidatit në të) kur bëri të qartë shenjtërinë e saj duke thënë: "Medineja është harem që nga mali Ir deri tek mali Theur. Kush shpik në të diçka të re ose praktikon në të diçka të shpikur, mbi të qoftë mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve. Nuk pranon Allahu prej këtij personi as shpenzim e as kompensim (as farz e as nafile)." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

- Nga mirësitë e saj është duaja që ka bërë Profeti salallahu alejhi ue selem për të pasur bereqet, siç thotë salallahu alejhi ue selem: "O Allah, na jep bereqet në frytet tona, na jep bereqet në Medinen tonë, na jep bereqet në enët tona, na jep bereqet në grushtin tonë (si njësi matëse)." (Transmeton Muslimi)

- Nga mirësitë e saj është se në të nuk hyn murtaja dhe as dexhali. Thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Në hyrjet e Medines ka engjëj (mbrojtës), nuk hyn në të

murtaja dhe as dexhali." (Transmeton Buhari dhe Muslim) Hadithet që flasin për vlerat dhe mirësitë e Medines janë të shumta, këto që përmenda janë vetëm disa të marra nga Dy Sahihet ose njëri prej tyre. Nga librat më të mirë që janë shkruar për mirësitë e Medines, është libri i përgatitur nga shejhu, doktori, Salih bin Hamid Rifai me të cilën mori gradën e doktoraturës në Universitetin Islamik të Medines (el Xhamiatul Islamijeh) me titull:"Hadithet që janë transmetuar për mirësitë e Medines - përmbledhje dhe studim." I porosis nxënësat e dijes që të kthehen tek ky libër dhe të përfitojnë prej tij. Gjithashtu ky qytet përfshin në veten e tij dy xhami madhështore:

- 1) Xhaminë e Profetit fisnik salallahu alejhi ue selem
- 2) Xhaminë Kuba

Për sa i përket xhamisë së Profetit salallahu alejhi ue selem janë transmetuar hadithe për mirësinë e saj. Thotë Profeti salallahu alejhi ue selem:"Nuk ndërmerret udhëtim përveçse për në tre xhami: Mesxhidul Haram (Qabe), në këtë xhaminë time dhe xhaminë Aksa." (Transmeton Buhari dhe Muslim). Në këtë qytet pra

gjendet njëra nga këto tre xhami të cilat janë ndërtuar nga profetër dhe nuk lejohet udhëtimi për në ndonjë xhami tjetër veç këtyre tre xhamive. Është transmetuar çfarë tregon për vlerën e namazit në xhaminë e Profetit salallahu alejhi ue selem dhe se një namaz në të është më i mirë se 1000 namaze diku tjetër, thotë salallahu alejhi ue selem: "Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë se 1000 namaze diku tjetër përveç Mesxhidul Haram (Qabes)." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

Kjo është mirësi e madhe dhe me përfitime të shumëfishuara, jo me dhjetëra e qindëra por me më shumë se 1000. Siç dihet tregtarët në këtë botë nëse marrin vesh se mallrat e tyre ecin më shumë në një kohë dhe vend të caktuar, përgatiten dhe marrin masa për këtë rast edhe sikur të ishte fitimi përgjysmë ose dyfishi, pra si është gjëndja kur fitimi, në këtë rast i botës tjetër, nuk është me 10 fish, as me 100 fish e as me 500 apo 600, por me më shumë se 1000?!!!

- Është e nevojshme të tërhiqet vëmendja rreth disa çështjeve që kanë të bëjnë me këtë xhami të bekuar:

1) Shumëfishimi i shpërblimit të namazit me më shumë se 1000 namaze nuk është vetëm për farzin e jo për nafilen, e as për nafilen e jo për farzin, por përfshin farzin dhe nafilen sepse fjala e Profetit salallahu alejhi ue selem: "Një namaz" është fjalë përgjithësuese. Pra farzi shpërblehet me 1000 farze dhe nafilja shpërblehet me 1000 nafile.

2) Ky shumëfishim nuk është vetëm për atë xhami (pjesë toke) që ka qenë në kohën e Profetit salallahu alejhi ue selem, biles përkundrazi çdo shtesë që i shtohet xhamisë ka të njëjtin gjykim. Argument për këtë është se dy halifet e drejtë, Umeri dhe Uthmani, e kanë shtuar xhaminë nga ana e përparme e siç dihet imami dhe safet e para ishin në shtesë, jashtë xhamisë që ka qenë në kohën e Profetit salallahu alejhi ue selem, e sikur të mos kishte shtesa, të njëjtin gjykim të xhamisë nuk do e kishin shtuar këta dy halife xhaminë nga ana e përparme plus që në atë kohë sahabet ishin me shumicë dhe askush nuk e kundërshtoi këtë veprim. Pra ky është argument i qartë se shumëfishimi nuk përkufizohet vetëm në atë xhami që ka qenë në

kohën e Profetit salallahu ue selem.

3) Në këtë xhami ka një pjesë të cilën e ka cilësuar Profeti salallahu alejhi ue selem se ajo është kopsht prej kopshteve të xhenetit, siç thotë në fjalën e tij: "Çfarë ka mes shtëpisë time dhe minberit tim është kopsht prej kopshteve të xhenetit (raudah)." (Transmeton Buhari dhe Muslim) Pra veçimi i kësaj pjese me këtë cilësi tregon për vlerën dhe dallimin e saj me kryerjen e nafileve në të, me dhikr, me lexim të Kuranit; kuptohet, nëse nuk lëndohet njeri (nga rrëmuja dhe njerëzit e shumtë).

Ndërsa namazi farz është më mirë të kryhet në safet e para, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Safi më i mirë i burrave është safi i parë dhe më i keqi është safi i fundit." (Transmeton Muslim) dhe thotë: "Sikur ta dinin njerëzit se çfarë ka në ezan dhe në safin e parë e të mos gjenin mënyrë tjetër që ti arrijnë ato veçse duke hedhur short, atëherë do hidhnin short për t'i arritur." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

4) Në qoftë se mbushet plot xhamia e Profetit e nuk ka më vend, atëherë lejohet për atë që vjen me vonesë të falet në rrugë me namazin e imanit, në tre drejtimet e tjera përveç drejtimin të imanit dhe e arrin shpërblimin e namazit me xhemat por jo shumëfishimin me më shumë se 1000 namaze, sepse ky shumëfishim është i veçantë për xhaminë e Profetit, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë se 1000 namaze diku tjetër përveç Mesxhidul Haram (Qabes)," dhe ai që falet në rrugë nuk konsiderohet se është falur në xhaminë e Profetit dhe nuk e arrin shumëfishimin.

5) Është përhapur tek shumë njerëz se kush vjen në Medine duhet patjetër të falë 40 namaze në xhaminë e Profetit, duke marrë si argument një hadith që transmetohet në Musnedin e imam Ahmedit nga Enesi radijallahu anhu nga Profeti salallahu alejhi ue selem: "Kush fal në xhaminë time 40 namaze pa i humbur asnjë namaz i shkruhet atij shpëtim nga zjarri, shpëtim nga dënimi dhe pastrohet nga nifaku." Ky hadith është i dobët nuk ia vlen për argument. Pra

çështja është e gjerë dhe nuk është i detyruar të falë një numër të caktuar namazesh, dhe çdo namaz në xhaminë e Profetit është më i mirë se 1000 namaze diku tjetër pa caktuar një numër të veçantë.

6) Janë sprovuar shumë muslimanë në vende të ndryshme islame me ndërtimin e xhamive mbi varreza ose varrosjen e të vdekurve në xhamia dhe mundohen disa ta bëjnë të lejuar këtë gjë duke u argumentuar me ekzistencën e varrit të Profetit në xhaminë e tij.

Përgjigja ndaj këtij dyshimi është se Profeti salallahu alejhi ue selem ishte ai i cili e ndërtoi xhaminë sapo mbërriti në Medine dhe ndërtoi dhomat në të cilat do banonin "nënat e besimtarëve "(gratë e Profetit) pranë xhamisë. Njëra nga këto dhoma ishte ajo e Aishes në të cilën vdiq dhe u varros Profeti salallahu alejhi ue selem. Këto dhoma ngelën ashtu siç ishin jashtë xhamisë në kohën e katër halifeve të drejtë, në kohën e Muauijes dhe në kohën e disa prijësve të tjerë pas tij. Gjatë sundimit të Beni Umejeve u zgjerua xhamia dhe u fut brenda saj dhoma e Aishes në të cilën gjendej i varrosur Profeti salallahu alejhi ue selem.

Janë transmetuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem hadithe të qarta që nuk pranojnë anulim, të cilat tregojnë ndalimin e marrjes së varreve si xhami, nga këto është hadithi i Xhundub bin Abdullah el Bexhelij, i cili e ka dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem 5 net para se të vdiste; thotë ai radijallahu anhu: E kam dëgjuar Profetin 5 netë para të vdiste duke thënë: "Unë jam i pastër tek Allahu se nuk kam marrë ndonjërin prej jush mik të dashur e të ngushtë (halil) sepse me të vërtetë Allahu më ka marrë mua të dashur të ngushtë (halil) ashtu siç e ka marrë Ibrahimin të dashur të ngushtë, e sikur unë të merrja ndonjë nga umeti im për mik të dashur e të ngushtë do e merrja Ebu Bekrin. Kanë qenë para jush njerëz të cilët i merrnin varret e profetëve të tyre dhe të njerëzve të mirë si xhamia, pra ju mos i merrni varret xhamia sepse unë ju ndaloj nga kjo gjë." (Transmeton Muslim)

Profeti salallahu alejhi ue selem edhe në çastet e fundit kur i erdhi vdekja tërhiqte vërejtjen që të mos merren varret si xhamia, siç transmetohet në Sahihejn (dy Sahihet) nga Aishja dhe Ibn Abasi thanë: Kur i erdhi vdekja Profetit, ai hidhte një copë (leckë) mbi fytyrën e tij

(e mbulonte atë), e kur vinte në vete e zbulonte fytyrën. Duke qenë në këtë gjendje tha: "Mallkimi i Allahut qoftë mbi çifutët dhe të krishterët sepse i morën varret e profetëve të tyre për xhamia;" duke tërhequr vërejtjen nga ajo çfarë bënin ata.'

Këto hadithe nga Aishja, Ibn Abasi dhe Xhundub janë të qarta dhe nuk pranojnë anulim në asnjë lloj mënyre, sepse hadithi i Xhundubit është në ditët e fundit të Profetit salallahu alejhi ue selem po ashtu hadithi i Aishes dhe Ibn Abasit është në çastet e fundit të jetës së tij prandaj nuk i lejohet askujt prej muslimanëve – persona qofshin apo xhемate - ta lënë atë që tregojnë këto hadithe të sakta e të qarta dhe të kapet pas një vepre që ka ndodhur në kohën e Beni Umejeve - futja e varrit të Profetit në xhami - duke e marrë si argument për të lejuar ndërtimin e xhamive mbi varre ose varrosjen e të vdekurve në xhami.

*Ndërsa përса i përket xhamisë Kuba, ajo është xhamia e dytë e cila ka mirësi dhe vlerë në Medine. Kjo xhami është e ndërtuar, e themeluar me devotshmëri që nga dita e parë e saj dhe është transmetuar nga vepra dhe fjala e Profetit që tregon për mirësinë e namazit në këtë xhami.

- Nga vepra e tij: Transmetohet nga Abdullah ibn Umeri që thotë: "Ishte Profeti që shkante tek xhamia Kuba çdo të shtunë në këmbë ose hipur mbi kafshë dhe falte në të dy rekate." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

- Nga fjala e tij: Transmetohet nga Sehl bin Hunejf që thotë: "Ka thënë Profeti salallahu alejhi ue sem: "Kush pastrohet në shtëpinë e tij, pastaj shkon në xhaminë Kuba dhe fal në të namaz merr shpërblimin e një Umreje." (Transmeton Ibn Maxheh) Fjala e tij: "Fal në të namaz" përfshin farzin dhe nafilen (pra qoftë farz ose nafile). Nuk është transmetuar në sunet diçka që tregon për mirësinë e ndonjë xhamie tjetër në Medine përveç këtyre dyjave që përmendëm.

*Përsa i përket edukatës që ka të bëjë me banimin në Medine.

Atij që Allahu ia ka bërë të mundur të banojë në këtë qytet të bekuar - Tajbete Tajjibeh -, duhet ta ndjejë dhe ta ketë parasysh se ka fituar një mirësi të madhe e ta falenderojë Allahun për këtë begati. Le ta dijë se janë të shumtë ata banorë të vendeve të tjera, të cilët dëshirojnë dhe e kanë mall të arrijnë në Meke e Medine dhe të qëndrojnë në to qoftë për një kohë të shkurtër. Ka prej tyre

që i mbledh paratë pak e nga pak për shumë vite me radhë vetëm e vetëm që ta realizojë këtë dëshirë të madhe. Po përmend këtu atë që më ka treguar një nga dijetarët e Indisë për haxhinjtë indianë, të cilët në të kaluarën vinin me anije me vela duke udhëtuar nëpër det për një kohë të gjatë derisa të arrinin në Meke dhe Medine. Njëherë një grup prej tyre po udhëtonin me anije dhe kur arritën të shihnin nga larg tokën në të cilën gjendej Meka dhe Medina, ranë në sexhde në shenjë falënderimi për Allahun mbi anije.

- Banimi në këtë qytet ka disa rregulla:

- 1) Ta dojë muslimani këtë qytet për mirësinë që ka dhe për dashurinë që kishte Profeti për të. Transmeton Buhari në Sahihun e tij nga Enesi radijallahu anhu se: Profeti kur kthehej nga ndonjë udhëtim dhe shikonte muret e Medines e nxiste, e shpejtonte devenë e tij, ndërsa nëse ishte i hipur mbi kafshë e shkundte atë nga gëzimi për arritjen në Medine."

2) Të kujdeset muslimani që t'i përmbahet dispozitave të Allahut në këtë qytet, të jetë nën bindjen e Allahut dhe të Profetit salallahu alejhi ue selem, të tregohet shumë i kujdesshëm që të mos bjerë në bidate apo mëkate. Veprat e mira në këtë qytet kanë vlerë të madhe, në të njëjtën kohë bidatet dhe gjynahet në të janë me rrezik të madh sepse ai i cili e kundërshton Allahun në harem, gjynahu i tij është më i madh sesa i atij që e kundërshton Allahun jashtë haremit. Të këqijat (gjynahet) nuk shumëfishohen në sasi por zmadhohen në vetvete për shkak të kryerjes së tyre në harem.

3) T'i kushtojë rëndësi muslimani që të fitojë sa më shumë nga tregtia e Ahiretit në këtë qytet, tregti e cila i ka fitimet e saja të shumëfishuara. Kjo gjë arrihet duke falur sa të mundet prej namazeve në xhaminë e Profetit salallahu alejhi ue selem që të marrë shpërblimin e premtuar në fjalën e Profetit salallahu alejhi ue selem: "Një namaz në këtë xhaminë time është më i mirë se 1000 namaze diku tjetër përveç Mesxhidul Haram (Qabes)." (Transmeton Buhari dhe Muslim)

4) Të jetë muslimani në këtë qytet shembull për mirë, sepse banon në vendin prej të cilit u shpërnda drita, u nisën nga ky qytet thirrësat përmirësues për në drejtime të ndryshme. Pra ai i cili viziton Medinen le të gjejë tek banorët e saj shembullin e mirë, njeriun e pajisur me cilësi fisnike dhe morale të larta duke u kthyer në vendin e tij i ndikuar për mirë dhe të ketë përfituar nga mirësitë që ka parë, nga kujdesi që i kushtohet bindjes së Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Në të njëjtën kohë siç mund të përfitojë vizitori i Medines hajr dhe mirësi nga vështrimi i shembullit të mirë në këtë qytet të bekuar po ashtu mund të ndodhë e anasjelltë nëse vizitori do shohë në Medine

të kundërtën e hajrit dhe mirësisë, pra në vend që të përfitojë dhe të lavdërojë do lëndohet dhe do nënçmojë.

5) Le të përkujtojë muslimani se ai është në një tokë të mirë e cila është djepi i shpalljes. Vendi në të cilin kthehet dhe mblidhet imani. Vendi në të cilin ka ecur Profeti salallahu alejhi ue selem dhe shokët e tij; ecën dhe qarkulluan në të me hajr, me përmbajtje ndaj së vërtetës dhe udhëzimit. Pra le të ketë kujdes

muslimani që të mos jetë lëvizja dhe qarkullimi i tij në kundërshtim me lëvizjen dhe qarkullimin e tyre. Mos të jetë lëvizja e tij në mënyrë që e zemëron Allahun dhe të meritojë përfundim të shëmtuar si në këtë botë dhe në Ahiret.

6) Atij të cilit Allahu ia ka bërë të mundur të banojë në Medine, le të ruhet nga shpikja e diçkaje të re në të apo nga praktikimi i diçkaje të shpikur më parë sepse rrezikon mallkimin, siç ka ardhur në hadith nga Profeti salallahu alejhi ue selem i cili ka thënë: "Medineja është harem (vend i shenjtë) prandaj kush shpik në të diçka të re ose praktikon në të diçka të shpikur, mbi të qoftë mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve. Nuk pranon Allahu prej këtij personi Ditën e Gjykimit as shpenzim e as kompesim (as farz e as nafile)." (Transmeton Muslim nga Ebu Hurejra si dhe në Sahihejn nga Aliu)

7) Të mos këpusë në Medine pemë (bimë), të mos gjuajë gjah sepse janë transmetuar hadithe nga Profeti salallahu alejhi ue selem në lidhje me këtë, si psh: "Me

të vërtetë Ibrahim i ka bërë të shenjtë (harem) Meken dhe unë e kam bërë të shenjtë Medinen çfarë ka ndërmjet dy anëve të saj. Nuk këputen pemët e saj dhe nuk gjuhet në të gjah." (Transmeton Muslim nga Xhabir bin Abdullah) Gjithashtu transmeton Muslimi nga Sad ibn ebi Uekas se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: "Unë e ndaloj që ndërmjet dy anëve të Medines të priten pemët e saj apo të vritet gjahu në të." Transmetohet në Sahihejn nga Asim bin Sulejman el Ehuel tha: i thashë Enesit: A e ka bërë të shenjtë Profeti Medinen? Tha: Po, që nga këtu e deri atje nuk priten pemët e saj. Kush shpik në të diçka të re, mbi të qoftë mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve." Gjithashtu transmetohet në Sahihejn nga Ebu Hurejra se ai thoshte: Sikur të shihja kafshë në Medine duke kullotur nuk do i trembja. Ka thënë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Çfarë ka ndërmjet dy anëve të saj është vend i shenjtë (harem)." Pemët (bimët) të cilat nuk lejohet prerja e tyre janë ato që i ka mbirë Allahu, ndërsa ato të cilat i kanë mbjellur njerëzit lejohet t'i këpusësh.

8) Të bëjë durim muslimani ndaj gjërave që e godasin në Medine qoftë vështirësi jetese, sprovë apo sëmundje sepse thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Nuk bën dikush durim nga umeti im ndaj ashpërsisë dhe vështirësive të Medines, veçse do jem ndërmjetësues dhe dëshmues për të Ditën e Gjykimit." (Transmeton Muslim) Transmetohet po në Sahihu Muslim se Ebu Seidi, rob i Mehriut, erdhi tek Ebu Seid el Hudrij netët e nxehta dhe i kërkoi një mendim rreth vendimit të tij për t'u larguar nga Medineja duke u ankuar nga çmimet, nga varfëria e madhe dhe e lajmëroi se nuk duronte dot ndaj vështirësive të Medines. I tha (Ebu Seid el Hudrij): Mjerë ti! Unë nuk ta këshilloj një gjë të tillë. E kam dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem duke thënë: "Nuk bën dikush durim ndaj sëmundjeve të saj (Medines) dhe vdes, veçse do jem për të ndërmjetësues Ditën e Gjykimit, nëse është musliman."

9) Të ketë kujdes që të mos lëndoje banorët e saj. Lëndimi muslimanit është diçka e ndaluar në çdo vend, por në vendin e shenjtë kjo ndalesë shtohet dhe përforcohet. Transmetohet nga Buhariu në Sahihun e tij nga Sad ibn

ebi Uekas tha:E kam dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem:"Nuk mundohet kush t'u bëjë keq banorëve të Medines, veçse do të tretet (humbasë) ashtu siç tretet kripa në ujë." Transmeton Muslimi në Sahihun e tij nga Ebu Hurejra tha:Tha Profeti salallahu alejhi ue selem:"Kush mundohet t'u bëjë keq banorëve të këtij vendi - dmth Medines - e tret (e zhduk) atë Allahu ashtu siç tretet kripa në ujë."

- 10) Mos të mashtrohen banorët e Medines nga fakti që ata janë banues në të e të thonë:Përderisa banoj në Medine jam mirë, jam në terezi, sepse thjesht vetëm fakti që ata janë banorë të saj nuk u bën dobi atyre nëse ata nuk bëjnë vepra të mira, i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, largohen nga mëkatet dhe të këqijat, biles mund të jetë me dëm për ta. Transmetohet në Muuetan e imam Malikut se Selman el Farisiu ka thënë: "Toka nuk e ngre lart askënd. Ajo e cila e ngre lart njeriun është vepra e tij." Megjithëse në zingjirin e transmetimit ka ndërprerje kuptimi i kësaj fjale është i saktë dhe në përputhje me realitetin. Thotë Allahu i Lartësuar:"**Më i nderuari (më fisniku) nga ju është ai**

i cili është më i devotshëm." (Huxhurat 13) Siç dihet në Medine në kohë të ndryshme ka pasur njerëz të mirë por ka pasur dhe të këqinj. Të mirëve u bën dobi puna e tyre ndërsa të këqinjët nuk i pastron dhe nuk i ngre lart Medineja. Kjo është si puna e prejardhjes. Thjesht, vetëm fakti që e ka prejardhjen e mirë pa bërë punë të mira nuk i bën dobi tek Allahu, sepse thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Kë e lë mbrapa puna e tij, nuk e çon përpara prejardhja e tij." (Transmeton Muslimi në sahihun e tij) Pra atë që e vonon puna e tij nga hyrja në xhenet, nuk mund ta shpejtojë prejardhja e tij.

- 11) Ta ndjejë muslimani në këtë qytet se gjendet në vendin prej të cilit buroi drita dhe u shpërnda dija e dobishme në të gjitha anët. prandaj t'i kushtojë rëndësi marrjes së dijes fetare me të cilën ecën drejt Allahut, duke pasur argumente dhe fakte të qarta si dhe i thërret të tjerët me dije dhe argumentim, sidomos nëse kryhet kërkimi i dijes në xhaminë e Profetit sepse është transmetuar nga Ebu Hurejra se e ka dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem duke thënë: "Kush hyn në

xhaminë tonë që të mësojë diçka të dobishme (hajr) ose t'ua mësojë të tjerëve, është si muxhahidi në rrugë të Allahut, ndërsa kush hyn për diçka tjetër është si shembulli i atij i cili vështroi diçka e cila nuk është e tij." (Transmeton Ahmedi, Ibn Maxheh, etj. po ashtu diçka e ngjashme transmetohet tek Taberani nga Sehl bin Sad)

*Ashtu siç kishte rregulla dhe edukata banimi në Medine gjithashtu dhe vizita e saj ka edukatën e vet. Kërkohet nga vizitori i Medines ruajtja e rregullave që përmendëm më sipër në lidhje me banimin në këtë qytet. Duhet të dihet se sipas sheriatit, ai i cili dëshiron të shkojë në Medine duhet të ketë për qëllim me këtë udhëtim vizitën e xhamisë së Profetit salallahu alejhi ue selem dhe ndërmarrjen e udhëtimit për tek kjo xhami, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Nuk lejohet të ndërmerret udhëtim përveçse për në tre xhamia: Mesxhidul Haram (Qabe), në këtë xhaminë time dhe në xhaminë Aksa." (Transmeton Buhari dhe Muslim) Ky hadith tregon se nuk lejohet të ndërmerret udhëtim për diku – xhami qoftë apo diçka tjetër - me qëllim që të

afrohet tek Allahu me këtë udhëtim. Siç transmetohet në Sunenin e Nesaiut nga Ebu Hurejra se tha: Takova Besrate bin ebi Besratel Gifari i cili më tha:Nga po vjen? I thashë: Nga mali Tur. Tha:Sikur të ishim takuar para se të shkoje atje nuk do të shkoje. I thashë: Po pse?

Tha: Unë e kam dëgjuar Profetin salallahu alejhi ue selem duke thënë:"Nuk ndërmerret udhëtim përveçse për në tre xhamia:Mesxhidul Haram (Qabe), në xhaminë time dhe në xhaminë e Bejtul Makdis (Aksa)." Hadithi është i saktë. Shihet qartë argumentimi që bëri Besrate bin ebi Besratel Gifari me këtë hadith për ndalimin e udhëtimit, qoftë për në xhamia apo diçka tjetër, përveç këtyre tre xhamive.

- Kush vjen në këtë qytet të bekuar është e pëlqyeshme për të të vizitojë dy xhamia dhe tre varreza.

Për sa i përket dy xhamiave, ato janë: Xhamia e Profetit salallahu alejhi ue selem dhe xhamia Kuba, përmendëm më sipër disa nga argumentet që tregojnë për vlerën e namazit në to. Ndërsa tre varrezat, të cilat është e pëlqyeshme të vizitohen janë:

*Varri i Profetit salallahu alejhi ue selem së bashku me varret e dy shokëve të tij, Ebu Bekrit dhe Umerit.

*Varreza e Bekies

*Varreza e dëshmorëve të Uhudit.

Vizitori kur vjen tek varri i Profetit dhe i dy shokëve të tij vjen nga ana e përparme, drejtohet nga varri dhe kryen një vizitë sipas sheriatit dhe i largohet vizitës sipas bidatit.

- Vizita sipas sheriatit është: t'i japë selam Profetit salallahu alejhi ue selem dhe të lutet për të me edukatë dhe zë të ulët duke thënë: Es-selamu alejke ja Rasulallah ue rahmetullahi ue beraketuhu, sal-lallahu ue sel-leme ue bareke alejke ue xhezake efdale ma xheza nebijen an umetihi

(Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguari i Allahut. Qoftë mbi ty mëshira dhe bekimi i Tij. Allahu ta shpërbleftë me shpërblimin më të mirë që ka shpërblyer profet për popullin e tij).

Pastaj i jep salam Ebu Bekrit dhe lutet për të. Pastaj i jep salam Umerit dhe lutet për të. Duhet të dihet se këta dy burrra të mëdhenj, këta dy halife të drejtë i ka nderuar Allahu me çfarë nuk ka nderuar askënd tjetër përveç tyre. Sa i përket Ebu Bekrit, ishte i pari nga burrat që i besoi Profetit salallahu alejhi ue selem kur e dërgoi atë Allahu me udhëzimin dhe të vërtetën. I qëndroi pranë Profetit salallahu alejhi ue selem në Meke pas shpaljes për 13 vjet. Ishte shoqëruesi i Profetit në rrugën e emigrimit kur i erdhi leja nga Allahu për emigrim dhe zbriti Allahu ajete Kuranore; fjala e Tij: "Nëse nuk e ndihmoni ju, atë e ka ndihmuar Allahu kur e nxorën pabesimtarët atë vetë të dytin, kur ata ishin në shpellë dhe i thoshte shokut të tij: Mos u mërzit, Allahu është me ne. E Allahu i zbriti qetësi aty, e ndihmoi me një ushtri që ju nuk e patë dhe bëri fjalën e atyre që nuk besuan më të ultën ndërsa fjala e Allahut është më e Larta. Me të vërtetë Allahu është më i Fuqishmi, më i Urti." (Teube 40) Gjithashtu i qëndroi pranë në Medine 10 vjet.

Ishte i pranishëm me të në të gjitha betejat. Kur vdiq Profeti salallahu alejhi ue selem, ai mori halifatin dhe drejtoi atë siç ishte më së miri. Kur vdiq e nderoi Allahu

duke u varrosur përkrah Profetit salallahu alejhi ue selem dhe kur të ringjallet do të jetë së bashku me të në xhenet. Kjo është mirësia e Allahut që ia jep kujt të dojë. Me të vërtetë Allahu posedon mirësi të madhe.

Përsa i përket Umerit: e kishin pranuar islamin para tij 40 burra. Para islamit ishte i ashpër ndaj muslimanëve ndërsa kur e udhëzoi Allahu në Islam e përdori forcën dhe ashpërsinë e tij ndaj kafirave. Ishte islami i tij krenari për muslimanët, siç thotë Abdulla bin Mesud:Qëkur ka pranuar Islamin Umeri kemi qenë gjithnjë krenarë." (Transmeton Buhari në Sahihun e tij). Qëndroi pranë Profetit salallahu alejhi ue selem gjatë kohës që ishin në Meke pastaj emigroi për në Medine. Mori pjesë në të gjitha betejat me Profetin salallahu alejhi ue selem, dhe ishte krahu i djathtë i Ebu Bekrit kur ai ishte halife, pastaj pas Ebu Bekrit e mori ai përsipër drejtimin e halifatit. Për më shumë se 10 vjet periudhë, në të cilën ndodhën çlirimet e shumta, u zgjerua territori i shtetit Islam, u shkatërruan dy perandoritë më të mëdha të asaj kohe - ajo e Persisë dhe e Bizantit -, u shpenzuan thesaret e Kirsasë dhe Kajsarit tamam ashtu siç kishte lajmëruar Profeti salallahu alejhi ue selem, gjë e cila u realizua nëpërmjet

duarve të Farukut (Umerit). Kur vdiq, e nderoi Allahu duke u varrosur përkrah Profetit salallahu alejhi ue selem; kur të ringjallet do të jetë me të në xhenet. Kjo është mirësia e Allahut që ia jep kujt të dojë. Me të vërtetë Allahu posedon mirësi të mëdha.

A mundet që këta dy burra të mëdhenj, të cilët gëzojnë këto mirësi dhe këtë pozitë, të ketë ziliqarë (hasedxhi) që i urren nga zilia apo të jetë dikush që i nënçmon?!! Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga poshtërimi. O Zot, na fal neve dhe vëllezërit të cilët na paraprinë me besim. O Zot, mos lejo që në zemrat tona të ketë zili për ata që kanë besuar. O Zot, me të vërtetë Ti je i Butë, i Mëshirshëm. O Zot, mos na i shmang zemrat tona nga e vërteta pasi që i ke udhëzuar ato dhe na dhuro mëshirën Tënde. Me të vërtetë Ti je Dhurues i Madh.

Ka transmetuar Ibn Kethiri në tefsirin e tij tek fjala e Allahut: "Nëse largoheni nga mëkatet e mëdha të cilat u janë ndaluar, Ne ju shlyejmë mëkatet e vogla dhe ju fusim në një vend të ndershëm." (Nisa 31) Nga Ibn ebi Hatim me zinxhirin e tij tek Mugira bin Muksim se ai tha: "Ishin që thoshin: 'Sharja e Ebu Bekrit dhe Umerit është prej mëkateve të mëdha.' Pastaj tha Ibn Kethiri: Them: Një

pjesë e dijetarëve kanë arritur në mendimin se kush i shan sahabet është kafir; ky mendim transmetohet nga Malik bin Enes. Ka thënë Muhamed bin Sirin: 'Nuk besoj që dikush ta urrejë Ebu Bekrin dhe Umerin dhe ta dojë Profetin salallahu alejhi ue selem.' (Transmeton Tirmidhiu)

- Vizita sipas bidatit është ajo e cila përmbledh këto pika:

- 1) T'i lutet Profetit salallahu alejhi ue selem, t'i kërkojë ndihmë atij, t'i kërkojë plotësimin e nevojave, largimin e fatkeqësive, etj gjëra këto të cilat nuk kërkohen veçse nga Allahu, sepse duaaja është adhurim dhe adhurimi i takon vetëm Allahut. Ka thënë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Duaja (lutja) është adhurim." Hadithi është i saktë e transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu, etj. Ka thënë Tirmidhiu: hadith hasen sahih (i mirë, i saktë)

Adhurimi është e drejtë e Allahut dhe nuk lejohet t'i jepet e drejta e Allahut dikujt tjetër veç Tij, sepse kjo është shirk. Allahut duhet t'i lutemi, tek Ai duhet t'i kemi

shpresat.

Nuk lejohet t'i lutemi Profetit, përkundrazi ne lutemi për të. Po ashtu dhe të vdekurit e tjerë, lutemi për ta por nuk ju lutemi atyre. Siç dihet Profeti salallahu alejhi ue selem është i gjallë në varr në jetën e Berzahut, me një jetesë më të mirë sesa të dëshmorëve dhe nuk e di formën e kësaj jetese veçse Allahu. Ajo është një jetë komplet ndryshe nga jeta para vdekjes, si dhe ndryshon nga jeta pas ringjalljes. Prandaj nuk lejohet t'i drejtohet lutja Profetit salallahu alejhi ue selem, e as t'i kërkohet ndihmë atij sepse kjo është adhurim dhe adhurimi nuk i takon askujt tjetër përveç Allahut.

- 2) Ti vendosë duart e tij mbi gjoks ashtu siç i vendos në namaz kur falet. Kjo gjë nuk lejohet sepse kjo është formë e cila tregon nënshtrim dhe përrulje para Allahut, formë e ligjëruar në namaz kur muslimani është në këmbë duke lutur Zotin e tij. Ishin shokët e Profetit salallahu alejhi ue selem gjatë jetës së tij që vinin tek ai dhe nuk vendosnin duart e tyre mbi gjoks kur i jepnin selam, e sikur të ishte diçka e mirë do na kishin paraprirë në këtë gjë.

3) Të fërkojë (të prekë) muret dhe dritaret që janë rreth varrit të Profetit salallahu alejhi ue selem apo në çdo pjesë tjetër të xhamisë apo në çfarëdolloj vendi qoftë. Kjo gjë nuk lejohet sepse nuk është transmetuar në sunet diçka e tillë dhe as nuk është vepruar nga selefët (të parët tanë të mirë), bile ky lloj veprimi është mjet dhe rrugë që të çon në shirk. Mund të thojë ndonjë nga ata që bëjnë këso lloj veprimesh: Unë e bëj këtë nga dashuria që kam për Profetin!! Ne i themi: Dashuria për Profetin salallahu alejhi ue selem është detyrë të jetë në zemrën e çdo muslimani më e madhe se dashuria për prindërit e tij, fëmijët e tij dhe të gjithë njerëzit, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Nuk beson ndonjëri prej jush derisa të jem më i dashur tek ai se prindërit e tij, fëmijët e tij dhe të gjithë njerëzit." (Transmeton Buhari dhe Muslim). Është detyrë ta dojë Profetin më shumë sesa veten e tij, siç është saktësuar nga hadithi i Umerit në Sahihul Buhari. Është obligim të duhet Profeti më shumë sesa vetja, prindërit dhe fëmijët, sepse mirësia që u bëri Allahu njerëzve nëpërmjet Profetit salallahu alejhi ue selem – mirësia e

Islamit, e udhëzimit në rrugë te drejtë, e nxjerrjes nga errësira në dritë - është më e madhe se çdo mirësi tjetër; nuk ka mirësi të ngjashme apo të barabartë me të. Duhet të kemi diçka parasysh: nuk është shenjë e dashurisë së Profetit fërkimi (prekja) e mureve apo dritareve, përkundrazi shenjë e dashurisë së Profetit salallahu alejhi ue selem është pasimi i tij dhe puna me sunetin e tij.

Feja islame është e ngritur mbi dy çështje të mëdha:

E para: Nuk e meriton adhurimin me të drejtë dikush apo diçka përveç Allahut. E dyta: Të mos adhurohet Allahu veçse në përputhje me atë që ka ardhur Profeti salallahu alejhi ue selem.

Kjo është përmbajtja e dëshmisë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut. Në Kuran gjendet një ajet të cilin disa ulema e quajnë ajeti i sprovës. Ky ajet është fjala e Allahut të Lartësuar: **"Thuaj: Nëse jeni që e doni Allahun, atëherë më pasoni mua (Profetin) ashtu që t'u dojë Allahu juve e t'ua falë mëkatet tuaja, me të vërtetë Allahu është Mëkatfalës, Mëshirues."** (Ali Imran 31) Thotë Hasen el

Basri e të tjerë nga selefët: 'Pretenduan disa njerëz se e duan Allahun prandaj i sprovai Allahu me këtë ajet.' Kjo fjalë e selefëve ka për qëllim se Allahu i sprovai ashtu që të dallohet i sinqerti nga gënjeshtari, sepse ai i cili pretendon se e do Allahun dhe të Dërguarin duhet të sjellë një fakt që e vërteton pretendimin e tij dhe ky fakt vërtetues është pasimi i Profetit salallahu alejhi ue selem. Thotë Ibn Kethiri në tefsirin e këtij ajeti: Ky ajet është gjykatës i çdokujt i cili pretendon se e do Allahun, mirëpo duke mos qenë në rrugën e Profetit salallahu alejhi ue selem ai është gënjeshtar derisa të pasojë sheriatin e Muhamedit dhe fenë e Profetit në të gjitha fjalët dhe veprat e tij, siç është saktësuar në Sahih nga Profeti se ka thënë: "Kush punon një vepër e cila nuk është në përputhje me fenë tonë, ajo është e refuzuar." Prandaj ka thënë i Lartësuari: **"Nëse jeni që e doni Allahun më pasoni mua (Profetin) që t'u dojë Allahu juve."** (Ali Imran 31) Pra do përfitoni dhe më shumë se ç'kërkuat ju - ta doni Atë dhe Ai t'u dojë juve sepse dashuria e Allahut është mirësi më e madhe se dashuria e njerëzve për Të, siç thonë disa dijetarë: Nuk është çështja që ti të duash por çështja është të të duan ty.' Pastaj ka përmendur fjalën e Hasen el Basrit

dhe selefëve të tjerë që e thamë më sipër.

Thotë imam Neueij në librin e tij "el Mexhmu" në lidhje me fërkimin (prekjen) dhe puthjen e mureve të varrit të Profetit: 'Mos u mashtro me gabimin e shumë njerëzve të thjeshtë, të cilët bëjnë veprime të tilla sepse jemi të urdhëruar të pasojmë dhe punojmë me hadithet dhe fjalët e dijetarëve, e nuk merren në konsideratë shpikjet e njerëzve të thjeshtë dhe injorancat e tyre.'

Është saktësuar në Sahihejn nga Aishja se Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë:"Kush shpik në fenë tone çfarë nuk është prej saj, ajo është e refuzuar," dhe në transmetimin e Muslimit:"Kush punon një vepër e cila nuk është në përputhje me fenë tonë, ajo është e refuzuar." Nga Ebu Hurejra se ai tha: Ka thënë Profeti salallahu alejhi ue selem:"Mos e bëni varrin tim vend feste. Çoni salavate për mua sepse salavatet tuaja më mbërrijnë mua kudo që të jeni." (Transmeton Ebu Daudi me zinxhir të saktë) Thotë Fudejl ibn Ijad (kuptimi i fjalës së tij): 'Pasoje rrugën e udhëzimit e mos u mërzi nga numri i pakët që ecin në të dhe largohu, ruaju nga rrugët e dalaletit (humbjes) e mos u mashtro nga numri i shumtë i të humburve.'

Dikujt mund t'i shkojë nëpër mend se prekja e mureve me dorë është për bereqet. Kjo vjen si pasojë e shkujdesjes dhe injorancës së tij sepse bereqeti gjendet në atë gjë që përputhet me sheriatin, e si mund të kërkohet mirësi duke kundërshtuar të vërtetën?!!

- 4) Të bëjë tauaf vizitori rreth varrit të Profetit salallahu alejhi ue selem - kjo gjë është haram sepse Allahu e ka ligjësuar tauafin vetëm rreth Qabes së nderuar. Thotë Alahu i Lartësuar: **"Dhe le të bëjnë tauaf rreth Shtëpisë së lashtë (Qabes)."** (Haxh 29) Pra nuk ka tauaf diku tjetër përveç Qabes. Mund të thuhet: Sa njerëz ka që falen për Allahun në çdo vend. Sa njerëz ka që japin sadaka për hir të Allahut në çdo vend. Sa njerëz ka që agjërojnë për Allahun në çdo vend. Sa njerëz ka që e përmendin Allahun në çdo vend, por nuk mund të thuhet: sa njerëz ka që bëjnë tauaf për hir të Allahut në çdo vend, sepse tauafi është veçori vetëm e Qabes së nderuar. Thotë shejhul islam Ibn Tejmijeh: 'Kanë rënë dakord të gjithë muslimanët se nuk lejohet tauafi veçse në Shtëpinë e shenjtë (Qabe); nuk lejohet tauafi rreth gurit të Bejtul Makdisit, as

rreth dhomës së Profetit salallahu alejhi ue selem, as rreth kubes që gjendet në malin e Arafatit, e as diku tjetër.'

- 5) Ngritja e zërit tek varri i Profetit salallahu alejhi ue selem - kjo gjë nuk lejohet sepse Allahu i ka mësuar besimtarët të sillen me edukatë kur Profeti ishte në mesin e tyre, siç thotë: **"O ju të cilët keni besuar, mos i ngritni zërat tuaj mbi zërin e Profetit, e mos i thërrisni atij me zë të lartë siç bëni me njëri tjetrin, që të mos ju zhduken veprat veprat tuaja ashtu pa e ndjerë (zhdukjen e tyre). Ata të cilët i ulin zërat e tyre pranë të Dërguarit të Allahut, i ka përshtatur Allahu zemrat e tyre për devotshmëri. Ata kanë falje mëkatesh dhe shpërblim të madh."** (Huxhurat 2-3)
- Profeti salallahu alejhi ue selem është i respektuar gjatë jetës së tij gjithashtu dhe pas vdekjes.

- 6) T'i drejtohet varrit nga një vend i largët qoftë në xhami apo jashtë tij dhe t'i japë selam Profetit salallahu alejhi ue selem. Ka thënë shejhu ynë, AbdulAziz bin Baz, në 'Mensikun' e tij: 'Ai i cili bën diçka të tillë është më afër

mosrespektit sesa dashurisë.'

- Ja vlen të tërheqim vëmendjen rreth diçkaje që bëjnë disa, nëse dikush do vijë në Medine atëherë familja e tij ose të tjerë e porosisin që t'i çojë salam Profetit salallahu alejhi ue selem nga ana e tyre. Nuk është transmetuar në sunet ndonjë argument për këtë gjë, ndaj i duhet thënë atij i cili porositi diçka të tillë:Shto salavatet dhe selamet mbi Profetin salallahu alejhi ue selem dhe melaiket ia dërgojnë Profetit salallahu alejhi ue selem, siç thotë ai vetë:"Me të vërtetë ka engjëj të Allahut që udhëtojnë nëpër tokë e më sjellin mua selamet e umetit tim." Hadithi është i saktë e ka transmetuar Nesai, etj dhe thotë Profeti salallahu alejhi ue selem:"Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza. Mos e bëni varrin tim vend feste. Çoni salavate mbi mua, sepse salavatet tuaja më mbërrijnë mua kudo që të jeni." Hadithi është i saktë, e ka transmetuar Ebu Daudi etj.

- Gjithashtu duhet të dihet se nuk ka lidhje mes Haxhit, Umres dhe vizitës së Medines. Mundet që ai i cili ka ardhur për Haxh ose Umre, të kthehet në vendin e tij pa e vizituar Medinen, ose mundet që të vijë nga vendi i tij të

vizitë Medinen dhe të kthehet pa bërë Haxh ose Umre. Po ashtu mundet t'i kryejë të gjitha këto në një udhëtim të vetëm - Haxh, Umre dhe vizitë.

Sa i përket ca haditheve që transmetohen për vizitën e varrit të Profetit salallahu alejhi ue selem si psh: "Kush bën haxh e nuk më viziton mua ka treguar mosrespekt," ose: "Kush më viziton pas vdekjes është sikur të më kishte vizituar gjatë jetës," ose: "Kush më viziton mua dhe babain tim Ibrahimin brenda një viti, i jam garant tek Allahu se do fitojë xhenetin," ose: "Kush e viziton varrin tim e meriton ndërmjetësimin tim;" të gjitha këto e të ngjashme si puna e tyre nuk janë argument, sepse ose janë hadithe të shpifura, ose shumë të dobëta, siç kanë thënë dijetarët e hadithit si Darekutni, Ukejli, Bejhaki, Ibn Tejmijeh, Ibn Haxher (Allahu i mëshiroftë të gjithë).

Kurse sa i përket fjalës së Alllahut: "E sikur ata të vinin tek ti pasi që i kanë bërë padrejtësi veteve të tyre e t'i kërkonin falje Allahut e edhe i Derguari të kërkonte falje për ta, do ta gjenin Allahun që e pranon pendimin dhe mëshiron shumë," (Nisa 64) nuk ka argument në këtë ajet

që të shkohet tek varri i Profetit salallahu alejhi ue selem kur dikush i bën padrejtësi vetes (duke bërë gjynahe) dhe t'i kërkojë Profetit që të bëjë istigfar për të, sepse në radhë të parë ajeti ka të bëjë me munafikët, pastaj në rradhë të dytë shkuarja tek Profeti salallahu alejhi ue selem kur ai ishte gjallë. Sahabet nuk shkonin tek varri i Profetit duke bërë istigfar dhe as nuk kërkonin nga Profeti që të bënte istigfar për ta, prandaj Umeri radijallahu anhu bëri ndërmjetësim me duanë e Abasit kur i goditi thatësira duke thënë:"O Allah, ishim që kur na godiste thatësira bënim ndërmjetësim tek Ti me Profetin tonë dhe na lëshoje shi, ndërsa sot po bëjmë ndërmjetësim me xhaxhain e Profetit tonë, prandaj, na lësho shi," dhe binte shi. (Transmeton Buhari në Sahihun e tij) Sikur të ishte i lejuar ndërmjetësimi me Profetin salallahu alejhi ue selem pas vdekjes së tij, nuk do zhvendosej Umeri tek ndërmjetësimi me Abasin radijallahu anhu; tregon për këtë gjithashtu ajo që transmeton Buhari në Sahihun e tij në "Kapitullin e të sëmureve" nga Aishja se ka thënë: O sa më dhemb koka! Tha Profeti salallahu alejhi ue selem:"Nëse të ndodhë kjo duke qenë unë gjallë do kërkoj falje dhe do lutem për ty," pra sikur të ishte që lutet dhe

bën istigfar pas vdekjes së tij, atëherë nuk do kishte dallim se kush vdiste më parë, Profeti salallahu alejhi ue selem apo Aishja.

*Për vizitën e varrit të Profetit salallahu alejhi ue selem argumentojnë ato hadithe, të cilat janë argument për vizitën e varreve në përgjithësi si psh fjala e Profetit salallahu alejhi ueselem: "Vizitoni varret sepse ato ju kujtojnë Ahiretin." (Transmeton Muslimi në Sahihun e tij) Mirëpo nuk duhet të zgjatet qëndrimi tek varri i Profetit dhe as shpeshtimi i vizitës, sepse kjo gjë mund të bëhet shkak që çon në gulu (teprim, kalim të kufijve). E ka veçuar Allahu Profetin e Tij duke bërë që engjëjt t'ia përcjellin selamet e umetit të tij nga çdo vend qofshin, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Me të vërtetë ka engjëj të Allahut që udhëtojnë nëpër tokë, më përcjellin mua selamet e umetit tim." Dhe thotë: "Mos i bëni shtëpitë tuaja varreza. Mos e bëni varrin tim vend feste. Çoni salavate mbi mua sepse salavatet tuaja më arrijnë mua kudo që të jeni," dmth nëpërmjet engjëjve.

*Ndërsa vizita e varrezës Bekie dhe varrezës së dëshmorëve të Uhudit, është e pëlqyeshme në qoftë se

kryhet në përputhje me sheriatin dhe është e ndaluar në goftë se kryhet e shoqëruar me bidate.

- Vizita sipas sheriatit është ajo e cila kryhet në përputhje me sunetin e Profetit salallahu alejhi ue selem duke përmbledhur në vetvete dobi për të gjallin që viziton dhe përfitim për të vdekurin që po vizitohet.

I gjalli, vizitori përfiton tre gjëra:

- 1) Përkujton vdekjen, gjë e cila e bën të përgatitet me vepra të mira, siç thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "Vizitoni varret sepse ato ju përkujtojnë Ahiretin." (Transmeton Muslim)
- 2) Kryerja e vizitës, gjë e cila është sunet i Profetit salallahu alejhi ue selem ndaj shpërblehet për këtë vepër.
- 3) Bën mirësi ndaj të vdekurve muslimanë duke u lutur për ta, gjë për të cilën merr shpërblim.

I vdekuri përfiton nga vizita sipas sheriatit lutjen që bëhet për të, sepse të vdekurit përfitojnë nga duaja e të gjallëve. Është e pëlqyeshme për atë i cili viziton varret që të lutet me ato dua, të cilat janë saktësuar nga Profeti salallahu alejhi ue selem për këtë rast, prej tyre hadithi i Burejde bin el Husejn ka thënë: Ishte Profeti salallahu alejhi ue selem që i mësonte kur të dilnin tek varrezat të thoshin: "Es-selamu alejkum ehled-dijari minel muminine uel muslimine, ue ina inshaAllahu bikum lelahikun. Es'elullahe lena ue lekum el afijeh." (Transmeton Muslim) Vizita e varreve është e pëlqyeshme për burrat, ndërsa përsa u përket grave, kanë rënë në hilaf (kundërshtim) dijetarët; ka prej tyre që e kanë lejuar dhe ka prej tyre që e kanë ndaluar. Fjala më e saktë është ajo e atyre që e kanë ndaluar vizitën e grave, sepse thotë Profeti salallahu alejhi ue selem: "I ka mallkuar Allahu ato gra që i vizitojnë varret." (Transmeton Tirmidhiu dhe ka thënë: hadith hasen sahih).

Më e sakta në komentin e fjalës "zeu-uarat" është: ato që kryejnë vizitë. E ngjashme me këtë është fjala e Allahut: "**Dhe nuk i bën padrejtësi Zoti yt njerëzve,**" (

Fusilet 46) pra nuk është "dhal-lam," që do të thotë nuk bën padrejtësi, nuk i takon Atij padrejtësia aspak. Po kështu dhe fjala "zeu-uarat" është e së njëjtës formë që tregon se nuk u takon grave që të vizitojnë varret dhe jo siç kanë thënë disa dijetarë, të cilët e lejojnë vizitën e grave, se fjala "zeu-uarat" ka për qëllim ato gra të cilat i shtojnë dhe i shpeshtojnë vizitat e varreve. Gjithashtu ndalohet për shkak se gratë nga vetë natyra e tyre janë të dobëta, nuk durojnë, nuk përmbahen nga të qarët dhe vajtimi. Në të njëjtën kohë fjala që e ndalon vizitën e grave është më e sigurt sepse nëse gruaja nuk i viziton varret, nuk i ka humbur asaj veçse diçka që është mustehab (e pëlqyeshme) ndërsa nëse e kryen vizitën rrezikon të meritojë mallkimin e Allahut të Lartësuar.

*Vizita sipas bidatit është ajo e cila kryhet në formë të ndaluar nga sheriati si psh: të vizitojë varret me qëllim që t'u lutet të vdekurve, t'u kërkojë ndihmë atyre, t'u kërkojë plotësimin e nevojave (kërkesave) që ai ka, etj. Nga kjo lloj vizite i vdekuri nuk përfiton ndërsa i gjalli, vizitori i bën dëm vetes sepse ka kryer diçka që nuk lejohet, ka bërë shirk, dhe i vdekuri nuk përfitoi gjë sepse nuk u lut për të.

Ka thënë shejhu ynë, AbdulAziz bin Baz, në "Mensik":Ndërsa vizita e të vdekurve që të lutet tek varret e tyre ose të qëndrojë tek ta, ose të kërkojë nga të vdekurit plotësimin e nevojave, ose të kërkojë nga ata shërimin e të sëmurëve, ose t'i lutet Allahut nëpërmjet tyre, ose t'i lutet Allahut me pozitën e tyre, etj. kjo është vizitë sipas bidatit, e urryer, jo e ligjëruar nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, nuk e kanë vepruar selefët diçka të tillë, biles kjo është nga huxhri (nga fjalë e shëmtuar, nga fjalët e palogjikshme) të cilën e ka ndaluar Profeti salallahu alejhi ue selem, ku thotë:"Vizitoni varret por mos thoni huxhtran (fjalë të shëmtuara, të urryera, të palogjikshme)." Të gjitha këto gjëra që i përmendëm i përmbledh fakti që ato janë bidat, kuptohet, ndryshojnë në gradë; ka prej tyre që janë vetëm bidat dhe nuk janë shirk si psh: të bësh dua tek varret, t'i lutesh Allahut me pozitën e të vdekurit, etj. ndërsa ka prej tyre që janë shirk i madh si psh: t'u lutesh të vdekurve, t'u kërkosht ndihmë atyre, etj.

Kjo ishte ajo që doja të përcillja tek ju. E lus Allahun që të na japë sukses ne, banorëve te Medines, vizitorëve te saj dhe të gjithë muslimanëve për punë të cilat kanë përfundim të lavdëruar si në këtë botë dhe në Ahiret. E lusim të na e bëjë rrizk një qëndrim të mirë dhe me edukatë në këtë qytet të mirë dhe të na japë një përfundim të mirë. Ue sal-lallahu ue sel-leme ue bareke ala abdihi ue rasulihi nebijjina Muhamedin ue ala alihi ue as’habihi exhmein.

Përktheu: Ebu Duxhanah
22 Rexheb, 1424 Hixhri, Medine.